

Artinda



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE JURIDIKE  
SEKTORI I SEKRETARI-ARKIVIT

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Prefekti i Qarkut Fier Nr.Prot. 184/, Data 08.02.2017

Shkurtimi i lëndës Idhimi pengjap

Për trajtim nga:	<u>Zj. Helios Helio</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	<u>Zj. Arlinda Kozdri</u>
Me porosi:	<u>12.02.2017</u>

Afati:  normal (7 ditë)  Prioritet (3 ditë)  Urgjent ( Brenda ditës )  Pa afat/ për dëjani Tjetër \_\_\_ ditë

Data 08.02.2017 Nr.Prot 636/

Nënshkrimi: (TITULLARI)

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim ( struktura ): \_\_\_\_\_

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim ( struktura ): \_\_\_\_\_

Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim: \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Kalon për trajtim specialisti: \_\_\_\_\_

Me porosinë: \_\_\_\_\_

- Trajtim i materialit përfunduar më: \_\_\_\_\_, Specialisti
- Trajtim i materialit pranuar më: \_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike
- Trajtim i materialit miratuar më: \_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike
- Trajtim i materialit miratuar më: \_\_\_\_\_, Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT FIER  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 184/1 Prot.

Fier, më 08.02 2024

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 03, Nr. 04, Nr. 06, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 30.01.2024.

**BASHKISË ROSKOVEC**  
**KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC**  
**Roskovec**

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 636 prot. datë 31.01.2024, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 184 prot. datë 05.02.2024, bazuar në ligjin Nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8, shkronja "a", neni 16, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3, pika 2, shqyrtuam ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 30.01.2024, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 01, datë 30.01.2024, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 69, prot. datë 05.01.2024, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimeve, shprehemi si më poshtë:

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 03, datë 30.01.2024, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2024"** shoqëruar nga projektvendimi Nr. 3, datë 25.01.2024, protokolluar me Nr. 465 prot. datë 25.01.2024, relacioni shpjegues Nr. 465/1 prot. datë 25.01.2024, është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b"; ligjin Nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 21; VKM Nr. 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave

të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimt të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” Kreu IV pika 1; Udhëzimin Nr. 5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” pika 4.

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 04, datë 30.01.2024, “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendor për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim dhe mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier”** është dërguar i shoqëruar nga nga projektvendimi Nr. 4 datë 25.01.2024, protokolluar me Nr. 466 prot. datë 25.01.2024, relacioni shpjegues Nr. 466/1 prot. datë 25.01.2024 dhe një kopje e marrëveshjes ndërvendore të bashkëpunimit për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim & mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier.

Nga verifikimi i vendimit së bashku me dokumentacionin shoqëruar rezulton se me anë të këtij vendimi, Bashkia Roskovec ka miratuar një marrëveshje bashkëpunimi ndërvendore me bashkitë e Qarkut Fier për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim dhe mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier.

Nga përmbajtja e marrëveshjes rezulton se gjashtë bashkitë e Qarkut Fier përfshirë bashkinë Roskovec, kanë rënë dakord për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe përcaktimin e një strukture të përbashkët e cila do të kryejë për llogari të gjithë bashkive palë në marrëveshje menaxhimin e pjesës së depozitimit, peshimit dhe rrugës hyrëse në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier.

Palët kanë rënë dakort që fusha e depozitimit të mbetjeve urbane në impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier të menaxhohet nga një strukturë e veçantë e quajtur **Sektor** e ngritur pranë Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Fier. Palët nënshkruese kanë marrë përsipër ti delegojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e veçanta Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Fier duke marrë përsipër angazhimet e nevojshme financiare për funksionimin e sektorit. Në marrëveshje është përcaktuar objekti i veprimtarisë së sektorit, afati, kontributi financiar si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Gjithashtu në marrëveshje është përcaktuar shprehimisht se ajo hyn në fuqi dhe bëhet e zbatueshme pas nënshkrimit nga palët, miratimit nga këshillat bashkiak dhe verifikimit të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut.

Sipas ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 8 shkronja “a”, “*Prefekti verifikon ligjshmërinë e vendimeve urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore*”.

Verifikojmë se në bazë të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3, pika 2, Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 04, datë 30.01.2024, “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendor për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim dhe mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier” nuk është me karakter normativ pasi nuk plotëson kriteret ligjore për tu klasifikuar si i tillë.

Në bazë të ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "j" përvec verifikimit të akteve me karakter normativ Prefekti verifikon ligjshmërinë edhe të disa akteve të tjera me karakter jo normativ kur kjo gjë kërkohet shprehimisht në akte ligjore ose nënligjore të caktuara.

Në rastin konkret lidhja e marrëveshjeve ndërvendore është e parashikuar në nenin 14 të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar).

Ky nen njih si përgjegjësi të Prefektit verifikimin e marrëveshjes ndërvendore të lidhur në zbatim të pikës 5 të tij. *Kjo pikë parashikon shprehimisht se dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme si dhe me institucione të qeverisjes qendore mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptim të këtij ligji ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes subjekti i kompetencave të përbashkëta njofton zyrtarisht Prefektin.*

*Marrëveshja bëhet e zbatueshme pas shprehjes së ligjshmërisë së Prefektit.*

Nga përmbajtja e marrëveshjes së dërguar nga ana juaj nuk rezulton të jetë krijuar ndonjë person juridik i pavarur nga palët. Sektori i ngritur pranë Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Fier nuk konsiderohet subjekt i kompetencave të përbashkëta në kuptim të ligjit të sipërcituar pasi nuk ka personalitet juridik por është një strukturë që vepron brenda Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Fier.

Gjithashtu neni 14 pika 6 e ligjit 139/2015 përcakton qartë se subjekti i kompetencave të përbashkëta ka detyrimin të dërgojë marrëveshjen për verifikim ligjor tek Prefekti dhe jo palët.

Pra, nuk plotësohen kriteret ligjore që kërkohen nga ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 14 pika 5 e në vazhdim që prefekti të ketë kompetencë të shprehet mbi marrëveshjen.

Për sa më sipër, bazuar në ligjin Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "j" ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 14 pikat 5, 6 dhe 8, verifikimi ligjor i Vendimit Nr. 04, datë 30.01.2024, i Këshillit të Bashkisë Roskovec "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendor për menaxhimin e landfillit (depozitim, peshim dhe mirëmbajtje e rrugës hyrëse) në impiantin e mbetjeve urbane të Qarkut Fier" nuk është në kompetencë të Prefektit të Qarkut.

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 06, datë 30.01.2024, "Për miratim buxheti shtesë dhe rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024"** është dërguar i shoqëruar nga nga projektvendimi Nr. 6 datë 25.01.2024, protokolluar me Nr. 468 prot. datë 25.01.2024, relacionet shpjeguese Nr. 468/1 prot. datë 25.01.2024 dhe Nr. 468/2 prot. datë 25.01.2024.

Ky vendim është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1/b, dhe 1.3/c, neni 54, shkronja "dh"; Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), neni 6, neni 15, neni 44; Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"



(i ndryshuar) neni 6, shkronja "d", neni 10, neni 22 pika I neni 23 pika I, neni 45 si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**PREFEKTI**

**Rajmonda Ballesaj**

